

## Tregues

1. Cfarë është shërbimi i urgjencës dhe i ndërhyrjes së shpejtë mjekësore (S.U.E.M.) 118
2. Kur të telefonosh
3. Si të telefonosh e çfarë të thuash
4. Organizimi i gjëndjes kritike në agjencinë Ulss 5 Vicentino perëndimore
5. Vlerësimi i rasteve në Ndhimën e shpejtë (triage)
6. Shërbimi i Ndimës së Shpejtë
7. Pika e ndërhyrjes së parë
8. Shërbimet falas dhe me pagesë
9. Përfundime diagnostike – mjekësore,ndikojnë në ndërhyrjen e Ndhimës së Shpejtë.

### 1. Cfarë është shërbimi i urgjencës dhe i ndërhyrjes së shpejtë mjekësore (S.U.E.M). 118

118 është një shërbim publik, falas, i ndërhyrjes së shpejtë shëndetësore për 24 orë çdo ditë, zhvillon një aktivitet që është **rizervuar vetëm urgjencave**, në të gjithë territorin kombëtar, në kontakt me mjetet e shpejta, spitalet, policinë, karabinierin, zjarrfiksen mbrojtësit e qytetarëve e me forzat vullnetare (Kryqi i Kuq italian).

Gjëndja kritike shëndetësore përmbledh situata që janë të pa parashikuara e te rënda që vënë në mënyrë të shpejtë në rrezik integrimin fizik e mbijetesën e individit.

Shërbimi i urgjencës dhe i gjëndjes kritike mjekësore (S.U.E.M) bëhet aktiv duke thirrur falas numrin 118 gjatë 24 orëve, çdo ditë.

Ndërhyrja e S.U.E.M është e kufizuar, në raste të tilla,në të cilat gjëndja e të sëmurit nuk lejon transportimin e të sëmurit me mjete të zakonshme. Sipas nevojave, ky shërbim, nis një ekuipazh infermierësh o mjekë e infermierë.

## 2. Kur të telefonosh

Shërbimi i 118 zhvillon aktivitetin 24 orë çdo ditë dhe i drejtohet vetëm **urgjencave / e gjëndjes kritike**. Ndërhyn në këto raste plagosje ose sëmundje të rënda, me paraqitjen e një ose më shumë kush-teve shëndetësore që vijojnë:

- © plagosje o sëmundje të rënda
- © humbje e ndryshim i vetëdijes
- © vështirësi në frymëmarrje
- © zbehje e djersë të ftohta për një kohë të gjatë
- © dhimbje të forta në gjoks ose në bark
- © dyshim të dëmtimit të shtyllës kurrizore
- © dyshim të thyerjes së gjymtyrëve të poshtëme e të legenit
- © plagë e madhe dhe shtypje
- © të vjella me ndryshim të vetëdijes.

**Në raste të tjera dhimbje o plagosje duhet ti drejtoheni mjekut tuaj ose mjekut të rojes.**

## 3. Si të telefonosh e çfarë të thuash

Për të kërkuar ndihmë është e mjaftueshme që të telefonosh nga çdo telefon numrin **118** (kjo telefonatë është falas, në telefonat publik nuk është e nevojshme që të përdorësh monedhat ose kartat) do të jeni kështu në kontakt me çentralin veprues që bashkërendit ndihmën e shpejtë.

Për provincën e Vicenzës, çentrali ndodhet pranë spitalit të Vicenzës.

Pasi të kesh bërë numrin 118 është e nevojshme që të presësh përgjigjen e punonjësve të çentralit e të përgjigjesh me saktësi të gjitha pyetjeve të punonjësit: vetëm kështu mund të lehtësosh dhe të shpejtosh nisjen e ndihmës së shpejtë.

Punonjësi, nëpërmjet disa pyetjeve të thjeshta, është në gjëndje të vërtetojë sa e rëndë është gjëndja e të stabilizojë cilat mjete është e nevojshme që të nisë: ambulancën, mjekun e reanimacionit, helikopterin, zjarrfiksen, forcat e policisë.

Nisja sa më e shpejtë e mjeteve të nevojshme mund të shërbejë për të shpëtuarnjë jetë, për këtë motiv është e rëndësishme që personi që telefonon ti përgjigjet të gjitha pyetjeve që i drejtohen nga punonjësi i centralit veprues.

Punonjësi bën këto pyetje:

- © Kush je
- © Nga ku telefonon
- © Ku ka ndodhur
- © Çfarë ka ndodhur
- © Sa persona janë pleksur
- © Sa e rëndë është gjëndja e këtyre personave
- © Numri i telefonit nga i cili po flet

Është e rëndësishme që të mos e mbyllësh telefonin deri në atë moment që të thotëpunonjësi

## 4. Organizimi i gjëndjes kritike në agjencinë Ulss 5 Ovest Vicentino

Për agjencinë Ulss 5 Vicentino perëndimore shërbimi i Urgjencës dhe i Gjëndjes kritike mjekësore **118** është i administruar nga Uniteti Operativ i NDIHMËS SË SHPEJTË të kësaj agjencie Ulss, në bashkëpunim me centralin Operativ S.U.E.M. Vicenza.

Çentrali operativ është i aftësuar të caktojë mjetin më të shpejtë që është i disponueshëm më afër vëndit të gjëndjes kritike duke shfrytëzuar dhe mjetet e shpejta të Agjencie të tjera Ulss.

Mbulimi operativ i rrjetit provincial 118 mbi territorin e Agjencisë Ulss 5 Vicentino perëndimore është i ndërtuar sipas mënyrave që vijojnë:

- © **Arzignano:** ambulanza me mjekun në bord nga ora 20.00 deri në orën 8.00 dhe më tej, ambulanca me infermierë në bord 24 orë në ditë.
- © **Lonigo:** ambulanza me mjekun në bord, 24 orë në ditë.
- © **Montecchio M.:** ambulanza me mjekun në bord nga ora 8.00 deri në orën 20.00
- © **Valdagno:** ambulanza me mjekun në bord nga ora 8.00

deri në orën 20.00, dhe nje ambulancë tjetër me infermiere në bord nga 8.00 deri në orën 20.00

Në territorin e Agjencisë janë të pranishme këto pika të ndihmës së shpejtë:

- © **Ndihma e shpejtë në spitalin Arzignanòs**  
Rruga del Parco, 1 - Tel. n. 0444 479397
- © **Ndihma e shpejtë në spitalin e Valdanjos**  
Rruga G. Galilei, 3 - Tel. n. 0445 423351
- © **Pikë e ndërhyrjes së shpejtë në spitalin e Lonigos**  
Rruga Sisana, 1 - Tel. n. 0444 431215
- © **Pikë e ndërhyrjes së shpejtë në spitalin e Montecchio M.**  
Rruga Cà Rotte, 7 - Tel. n. 0444 708146  
Orari: çdo ditë nga ora 9.00 deri në orën 18.00

Të tilla shërbime bëjnë pjesë në strukturën e Ndhmës së Shpejtë, primar i së cilës është **Dot. Giordano Guizzardi** (përgjegjës salle i Ndhmës së Shpejtë Arzignano: **Stefano Marcolin**: përgjegjës salle i Ndhmës së Shpejtë të Valdagnos: **Rosella Caneva**).

Përveç kësaj, ky shërbim është futur në një strukturë më të madhe, që është quajtur **Dipartiment i gjëndjes kritike dhe i mjekimit të shpeshtë**, përgjegjës i të cilit është **Dot. Dario Mastropasqua**.

**Informacionet** e kërkuara nga përdoruesit, në telefon ose drejt-përdrejt personelit shëndetësor, **janë të nënshtruara ligjit mbi privacy**. Përgjigjet do të jenë të lidhura me mënyrat e organizimit të Ndhmës së Shpejtë: nuk do të jepen në telefon, këshilla të zgjedhura të natyrës mjekësore.

## 5. Vlerësimi i rasteve në Ndhimën e Shpejtë (triage)

I sëmuri pritet në ndihmën e shpejtë nga një infermiere profesionale që shënon gjeneralitetet dhe vlerëson gjëndjen e përgjithëshme klinike.

Në lidhje me faktin se sa e rëndë është gjendja e të sëmurit, infermieri i jep një kod hyrje (kodin e gjëndjes) ambulateve të Ndhimës së Shpejtë, që dallohen nga ngjyra e që përcakton përparësinë e hyrjes në këtë shërbim.

Zgjedhja e pacientëve që janë në gjëndje më të rëndë, përcaktohet nga fjala “triage” që i përgjigjet një parimi thelbësor “trajtohen më parë rastet më urgente”.

Në Ndhimën e Shpejtë mund t’ju takojë që të prisni për një kohë të gjatë. Kjo pritje do të thotë që personeli është duke trajtuar personat që i përkasin kodeve të gjëndjes së rëndë.

Kodet që përcaktojnë gjëndjen e pacientit:

### © **I KUQ - Gjëndje kritike**

I jepet të sëmurëve në gjëndje më të rëndë që rrezikojnë jetën. Në qoftë se është e nevojshme Ndhimja e Shpejtë bllokun të gjitha aktivitetet për të ndjekur këta të sëmurë. Në këtë rast nuk ka kohë për të pritur.

### © **I VERDHË - Ndhimë e Parë**

Është i rezervuar të sëmurëve që shfaqin ndryshime në funksionimin e frymëmarrjes, të zemrës, nervor o traumë të veçantë. Ndhimja e Shpejtë, do të jepet sa më shpejtë të jetë e mundur.

### © **I GJELBËR - Ndhimë e dorës së dytë**

Niveli i Ndhimës së Shpejtë është i tillë që mund të presë. Pacienti do të kontrollohet sapo të jetë dhënë Ndhimja e Parë pacientëve në gjëndje të rëndë. Pacienti është i lutur që të presë. Personeli do të bëjë të pamundurën për të shkurtuar kohën e pritjes.

### © **I BARDHË**

Në këto raste nuk paraqitet nevoja për një ndihmë shumë të shpejtë, ky pacient do të hyjë vetëm kur të jenë vizituar të gjithë rastet urgente edhe pse kanë arritur më pas.

## 6. Shërbimi i Ndhmës së Shpejtë

Ndihma e Shpejtë është një Unitet Operativ që i kushtohet aktiviteteve të diagnostikimit e të mjekimit të Urgjencave e të Gjëndjes Kritike shëndetësore që funksionon 24 orë çdo ditë.

Është një shërbim është në dispozicion të qytetarëve që mund të kontribuojnë në funksionimin e mirë të këtij shërbimi duke ju drejtuar vetëm kur kanë nevojë për trajtime urgente, që nuk mund të presin e nuk mund të trajtohen nga strukturat e tjera shëndetësore të agjencisë Ulss 5 Vicentino Perëndimor (mjekësia dhe pediatria e bazës, distrikt e ambulator i specializuar).

Qytetarët që kanë nevojë për mjekime urgente mund ti drejtohet directë picave më të afërta të Ndimës së Shpejtë, pikë e ndërhyrjes së parë ose ti drejtohet Shërbimit të Urgjencës e të gjëndjes kritike 118, që vë në funksionim ambulancën.

Sapo arrin në ndimën e Shpejtë, hyrja në shërbimet shëndetësore përcaktohet në bazë të gjëndjes së pacientit dhe jo në bazë të rradhës, pasi të jetë bërë seleksionimi i nga personeli shëndetësor i pritjes.

Ndihma e Shpejtë mban lidhjen me çentralin operativ dhe ka në dispozicion:

- © mjete të zakonshme trasporti;
- © mjete trasporti për urgjenca - gjëndje kritike që janë të lidhura me çentralin operativ.

## 7. Pika e Ndërhyrjes së Parë

Pika e Ndërhyrjes së Parë është e para që i përgjigjet problemeve të urgjencës dhe të gjëndjes kritike të qytetarëve që paraqiten papritur ose i bën trajtimin përfundimtar problemeve të vogla, si për shembull goditjeve të vogla ose plagosjeve.

Në rast se është e nevojshme, pacienti mund të transferohet me ambulancë, me mjek në bord, pranë Ndhmës së Shpejtë në spitalit më të afërt, për trajtimin e nevojshëm.

## 8. Shërbimet falas dhe me pagesë

Shërbimet diagnostike - mjekuese, që bëhen në ambulatorin e Ndhmës së Shpejtë dhe ato që kërkohen, janë me pagesë sipas tarifave të krahinave, me përjashtim të rasteve:

- © shërbimet e ndjekura gjatë shtrimit
- © shërbimet në lidhje me plagosjet në punë (INAIL)
- © kush është në zotërim të përjashtimit nga të gjitha pagesat për motive të parashikuara nga ligjet.
- © shërbimet e kryera në rastet egjëndjes kritike dhe kur pacienti rrezikon jetën
- © Shërbimet e kryera në situata urgjente. Mungesa e këtij shërbimi, mund të sjellë keqësimin e gjëndjes së përgjithëshme ose mund të shkaktojë komplikacione të rënda.

## 9. Përfundimet diagnostike - mjekësore që mund të ndiqen në ndërhyrjen e Ndhmës së Shpejtë

- © **DALJA:** rruga e diagnostikimit mbyllet në Ndhmën e Shpejtë ose pacienti dërgohet tek mjeku i mjeksisë së përgjithëshme për trajtime specialistike ambulatoriale.  
Dalja nga Ndhma e Shpejtë shoqërohet në çdo rast me dhënien e kartelës klinike dhe të dokumentave të pacientit.
- © **VËZHGIMI:** Pacienti qëndron brënda në Ndhmën e Shpejtë në një zonë të quajtur “Njësi vëzhgimi” e pajisur pikërisht me shtretër e personel që i kushtohet për më pak se 24 orë dhe për të lejuar qartësime diagnostike dhe trajtime të përshtatëshme.
- © **SHTRIMI:** bëhet në rast se pacienti ka nevojë për thellime diagnostike - mjekësore që bëhen shtrimi.
- © **TRANSFERIMI:** pacienti mund të transferohet pranë strukturave të tjera mjekuese në bazë të nevojave të veçanta.

Azienda Ulss 5 Ovest Vicentino

Ufficio Relazioni con il Pubblico

Via Trento, 2 – 36071 Arzignano (VI)

Tel. n. 0444 708200 – Fax n. 0444 479615

e-mail: [urp@ulss5.it](mailto:urp@ulss5.it)

Orari: nga e Hëna deri të Enjten nga ora 9.00 deri në orën  
13.00 dhe nga ora 14.00 deri në orën 16.30, të Premten nga  
ora 9.00 deri në orën 13.00.